

KOMUNIKATË PËR MEDIA

23 mars 2007

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit shtyn afatin e fundit të parakualifikimit dhe ditën e ofertimit për katër ndërmarrje të valës 23

PRISHTINË – Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) shtyn afatin e fundit për parakualifikim dhe ditën e ofertimit për këto ndërmarrje të valës 23: **“Thertorja Eksportuese”**, **“Sharrprodhimi - Fermat në Mejdan”**, **“Mirusha - Vreshtat/Toka Bujqësore Malishevë”** dhe **“Mirusha - Vreshtat/Toka Bujqësore Banjë.”**

“Ndërmarrja e Re Mirusha - Vreshtat/Toka Bujqësore Malishevë Sh.P.K.” dhe “Ndërmarrja e Re Mirusha - Vreshtat/Toka Bujqësore Banjë Sh.P.K.”, janë përfshirë në valën 24 dhe dita e fundit për parakualifikim do të jetë me 16 maj 2007, ndërsa dita për dorëzim të ofertave do të jetë me 23 maj 2007.

Ndërsa Ndërmarrja e Re “Thertorja Eksportuese Sh.P.K. dhe Ndërmarrja e Re “Sharreprodhimi - Fermat në Mejdan” Sh.P.K. janë shtyre për Valën 25 të privatizimit dhe do të shpallen së bashku me ndërmarrjet tjera të asaj vale.

Të dhëna për këto ndërmarrje:

[Ndërmarrja e Re Mirusha “Vreshtat/Toka Bujqësore Banjë” Sh.P.K.](#) - përfshin vreshta (jo aktiv), gjithashtu dhe tokë lavërtare me një sipërfaqe përafërsisht prej 1,100 hektarësh dhe duke përfshirë një numër të ndërtesave me një sipërfaqe totale të përafërt prej 2,200 m².

Ndërmarrja e Re ofron sipërfaqe të mjaftueshme tokësore të përshtatshme për prodhimin e rrushtit si dhe kultivimin e drithërave të ndryshme në shkallë industriale. Kushtet klimatike gjithashtu dhe toka i mundësojnë pronarit të ardhshëm kultivimin e rrushtit.

[Ndërmarrja e Re Mirusha “Vreshtat/Toka Bujqësore Malishevë” Sh.P.K.](#) - përfshin vreshta (jo aktiv), gjithashtu dhe tokë lavërtare me një sipërfaqe përafërsisht prej 400 hektarësh dhe duke përfshirë një numër të ndërtesave me një sipërfaqe totale të përafërt prej 3,000 m².

Ndërmarrja e Re ofron sipërfaqe të mjaftueshme tokësore të përshtatshme për prodhimin e rrushtit si dhe kultivimin e drithërave të ndryshme në shkallë industriale. Kushtet klimatike gjithashtu dhe toka i mundësojnë pronarit të ardhshëm të mirret me kultivimin e drithërave dhe prodhimeve tjera bujqësore.

[Ndërmarrja Re Sharrprodhimi "Fermat në Mejdan" Sh.P.K.](#) - do të përfshijë në sipërfaqe totale të përafërt me 450 hektarë të tokës duke përfshirë edhe ndërtesa (7) secila prej të cilave ka në sipërfaqe të përafërt me 1,500 m² të cilat janë të regjistruara në emër të NSH-s.

[Ndërmarrja e Re “Thertorja-Exportuese” Sh.P.K.](#) - është një kompani atraktive të përpunimit të mishit dhe është i vetmi prodhues i licencuar në regjionin e Prizrenit.

Ndërmarrja prodhuese gjendet në zonën industriale dhe ka një sipërfaqe përafërsisht 1.76.61 hektarësh, duke përfshirë 3 njësitë punuese dhe ndërtesën e administratës.